

## KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Kjo Kontratë Shitblerje Kuotash lidhet në Tiranë, më 09.09.2025 ("Marrëveshja") ndërmjet:

**Z. Ronald LORISTON**, shtetas Britanik, atësia Petref, lindur në Drenovc, më datë 28.09.1978 banues në Tiranë në adresën: Lunder "Rezidencia Sunrise, Tiranë, mbajtës i Pasaportës Britanike me nr. 133666092, me shtetesi shqiptare, njohesh dhe zoterues shume i mire i gjuhes shqipe, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.(këtu e më poshtë referuar si "Shitësi"),

Dhe

**Fiorela QOSHJA** shtetase Shqiptare, atësia Fatmir, lindur ne Tiranë më datë 27.04.1989, banues në Tiranë, në adresën: Rruga " e Durresit ", Njësia nr 10, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar mbajtës I leternjoftimit ID.Nr 039174456, Nr personal I95427060J, data e lëshimit 01.11.2023.(këtu e më poshtë referuar si "Blerësi").

(Shitësi dhe Blerësi në vijim referuar, bashkarisht dhe vecmas, si "Palët"/" Palë".)

### MEQËNËSE:

A. Shitësi është ortak i shoqërisë "Metafenix" Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar pranë regjistrat tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me NUIS M51324034R, me seli të regjistruar në adresën: "Pasuria e llojit Truall + Ndertese me Nr.Pasurie 53/51, Zone Kadastrale 2735, Volum 10, Faqe 23, Mullet , Tiranë, Shqipëri ("Metafenix" ose "Shoqëria") dhe zotëron një kuotë të Shoqërisë e cila përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë;

B. Kapitali i Shoqërisë është 10,000 Lekë (Dhjetmijë lekë), i ndarë në 1 (një) kuotë, me strukturë ortakëri si vijon:

- Ortaku themelues: **Ronald LORISTON** zotëruesh i një (1) kuote me vlerë të barabartë me 10,000 Lekë që përbën 100% (Njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

C. Blerësi i është drejtuar Shitësit dhe ka paraqitur një ofertë për blerjen e një pjese të kuotës së kapitalit të Shoqërisë sipas dhe në përputhje me kushtet e parashikimet e kësaj Kontrate;

D. Në vijim të bisedimeve të zhvilluara në mirëbesim ndërmjet Shitësit dhe Blerësit, Shitësi ka rënë dakort t'i shesë Blerësit dhe Blerësi ka rënë dakort të blejë nga Shitësi një pjesë të kuotës së kapitalit të Shoqërisë, në përputhje me kushtet e parashikimet e kësaj Kontrate.

E. Organet kompetente të Shoqërisë, të Shitësit dhe të Blerësit kanë marrë të gjitha vendimet e nevojshme për miratimin e këtij transaksi.

NË VIJIM, duke marrë në konsideratë parashtrimet e mësipërme si dhe marrëveshjet dypalëshe të këtushme, Palët bien dakort si vijon:

### **Neni 1**

#### **Kushtet paraprake**

1.1 Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e kësaj Kontrate.

### **Neni 2**

#### **Shitja, Blerja dhe Transferimi i Kuotës**

2.1 Shitja dhe Blerja e kuotës. Në varësi të kushteve dhe parashikimeve të kësaj Kontrate, Shitësi do t'i shesë Blerësit dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi, një kuotë që përfaqëson 33% të kapitalit të Shoqërisë (“Kuota”) dhe të gjitha të drejtat e lidhura me Kuotën.

2.2 Transferimi i titullit mbi Kuotën. Palët bien dakort që transferimi nga Shitësi tek Blerësi i titullit mbi Kuotën do të ndodhë menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Kontrate nga Palët (“Data e Nënshkrimit”). Secila Palë do të ketë të drejtë të regjistrojë transferimin e Kuotës sipas kësaj Kontrate pranë regjistrat tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Titulli i Kuotës do t'i transferohet Blerësit dhe Kuota do të shitet dhe do të blihet së bashku me të gjitha të drejtat, përfitimet dhe detyrimet që i bashkangjiten Kuotës ose që rrjedhin nga ajo në Datën e Nënshkrimit (duke përfshirë të drejtën për marrjen e të gjithë dividentëve, shpërndarjeve apo çdo kthimi të kapitalit/investimit të regjistruar, të paguar ose të kryer në Shoqëri).

2.3 Çmimi i Blerjes. Lidhur me transferimin e Kuotës, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një çmim prej 3,300.00 Lek (Tremijë e treqind lek) (“Çmimi i Blerjes”).

2.4 Pagesa. Palët bien dakort se Çmimi i Blerjes do t'i paguhet Shitësit në cash, brenda dhe jo më vonë se 30 (dhjetë) ditë pune nga Data e Nënshkrimit të kësaj Kontrate.

### Neni 3

#### Deklarime dhe Garanci

3.1 Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetmi pronar dhe titullar i Kuotës dhe të drejtave që rrjedhin prej saj.

3.2 Shitësi deklaron dhe garanton se Kuota është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve.

3.3 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe në çfarëdo momenti tjetër të mëtejshëm pas lidhjes së saj, Shitësi i garanton Blerësit akses – pranë selisë së Shoqërisë – në origjinalat e librave kontabël të Shoqërisë dhe çdo dokumenti tjetër që aktualisht është në dispozicion/pronësi të Shoqërisë, ose që duhet apo do të jetë më pas në dispozicion/pronësi të saj.

3.4 Shitësi deklaron dhe garanton se Shoqëria është themeluar dhe operon rregullisht në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në bazë të ligjit dhe të akteve të Shoqërisë dhe ka të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin që rregullon funksionimin e saj.

3.5 Shitësi deklaron dhe garanton se Shoqëria nuk ka detyrime ndaj palëve të treta deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate. Nëse do të rezultojnë detyrime të tillë, Shitësi deklaron dhe garanton që do tëjenë në ngarkim të tij dhe do të shlyejë apo rimbursojë Shoqërinë për çdo detyrim.

3.6 Shitësi deklaron dhe garanton se Shoqëria nuk është në proces falimentimi dhe likuidimi të vullnetshëm ose jo, apo në ndonjë proces të ngashëm.

### Neni 4

#### Korrespondenca

4.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat apo komunikimet e tjera ndërmjet Palëve duhet të bëhen vetëm me shkrim dhe të dërgohen pranë selisë së secilës Palë, si më sipër përcaktuar.

4.2 Të gjitha njoftimet, kërkesat apo komunikimet e tjera do të dërgohen me anë të letrës rekomande me kthim përgjigje ose me e-mail.

4.3 Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër do të konsiderohet i marrë efektivisht nëse ekzistojnë kushtet e mëposhtme: a) është dërguar me e-mail, në momentin në të cilin është marrë e-mail; b) nëse është dërguar me letër rekomande, në datën e dorëzimit tek marrësi që do të vërtetohet me fletën e kthimit.

### Neni 5

#### Shpenzime dhe taksa

5.1 Secila Palë do të mbulojë kostot dhe shpenzimet e saj në lidhje me negocimin, përgatitjen, nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj Kontrate.

5.2 Në çdo rast detyrimet tatimore do ti ngarkohen secilës Palë sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

## Neni 6

### **Legjislacioni i zbatueshëm dhe Juridikzioni**

6.1 Interpretimi, vlefshmëria, kryerja dhe ekzekutimi i kësaj Kontrate do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

6.2 Çdo mosmarrëveshje e lindur mbi, apo në lidhje me këtë Kontratë do të zgjidhet nga Palët me negocim ndërmjet tyre.

6.3 Nëse Palët nuk do të arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen nëpërmjet negociatave miqësore, brenda 10 (dhjetë) ditësh pune, secila Palë mund t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e saj.

## Neni 7

### **Anekset**

7.1 Janë pjesë thelbësore e kësaj Kontrate anekset vijuese:

- Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, Ekstrakteti dhe mjetet e identifikimit.

Kjo Kontratë nënshkruhet në tre ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe.

#### **Shitësi**

Emri / Name: Ronald LORISTON



#### **Blerësi**

Emri / Name: Fiorela QOSHJA

